


Johann Wolfgang von Goethe  
dhe marrdhēnā e tñ me Yenē

nga  
Shejh Abdulkadr Al-Murabbi



جده 'ن مارثاشت | Goethe



TË JETOSH DHE TË VDESËSH NË ISLAM

**JOHANN WOLFGANG  
VON GOETHE  
DHE MARRDHËNIA E  
TIJ ME FENË**

NGA

**SHEJH ABDULKADIR AL-MURABIT**

Tiranë 2000

**TITULLI I ORIGJINALIT:**  
**SHAYKH 'ABDULQADIR AL-MURABIT,**  
**FATWA ÜBER DIE ANERKENNUNG**  
**J.W.v. GOETHES ALS MUSLIM,**  
**WEIMAR, 1995**

**PËRKTHEU:**  
**EDVIN CAMI**

**REDAKTOI:**  
**ERVIN HATIBI**

**NËN KUJDESIN E:**  
**TE RINJVE MUSLIMAN TE TIRANES**  
**PËRKTHYER DHE BOTUAR ME LEJEN E**  
**INSTITUTIT ISLAM TË VAJMARIT- GJERMANI**

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBAJTJA.....</b>	4
<b>PARATHËNIE.....</b>	5
<b>EVIDENCA GËTE DHE KRISHTËRIMI.....</b>	6
TË PËRMENDURIT DHE TË LËVDUARIT E ZOTTIT.....	9
GËTE DHE ISLAMI.....	10
<b>PERFUNDIM.....</b>	25

## PARATHËNIE

Johann Wolfgang von Goethe (1748-1832) është, pa dyshim, poeti dhe mendimtari më i njohur i Klasikës Gjermane. Si student i gjermanistikës, interesi im i veçantë për letërsinë gjermane në përgjithësi dhe Gëten në veçanti u bë shkak që të njihemi me këtë botim interesant të Institutit Islamik të Vajmarit.

Megjithëse përfundimet në të cilat arrin autor i kësaj eseje, jo pa të drejtë, mund të shihen me skepticizëm nga shumë njerëz, nuk mbetet asnje shteg për të dyshuar rrëth qëndrimit shumë pozitiv të poetit të madh gjerman ndaj Islamit.

Duke qenë i mendimit se aspekti fetar i jetës J.W.v. Goethe-s dhe, në këtë kuadër, marrdhënia e tij me Islamin, e cila gjen shprehjen më të quartë në poemën **“West-Östlicher Divan”** (1819), janë të panjohura për shumë njerëz, dëshiroj të ndaj me lexuesin shqiptar dhe veçanërisht me dashamirësit e letërsisë, kënaqësinë e një njohjeje më të gjerë me poetin e madh gjerman.

**Përkthyesi**

## EVIDENCA

### GËTE DHE KRISHTËRIMI

Gëte tha në fund të jetës së tij: “**Es ist gar viel Dummes in den Satzungen der Kirche**” (*Ka shumë budallallëk në doktrinat e Kishës*) [Bashkëbisedim me Eckerman, 11.3.1832]

Në poemën e tij “**West-Östlicher Divan**” Gëte thekson vlerën e çmuar të së tashmes në vend të qëndrimit të krishterë, të karakterizuar vetëm nga pritja për jetën e ardhshme dhe, si rezultat, përcmimi i plotë i asaj që Zoti i dhuron njeriut në çdo çast të jetës së tij.

Gëte hedh poshtë pikëpamjen e krishterë rrëth Jezusit dhe pohon njëshmërinë e Allahut në njëren nga poezitë e poemës së tij “**West-Östlicher Divan**”:

“**Jesus fühlte rein und dachte  
Nur den einen Gott im Stillen;  
Wer ihn selbst zum Gotte machte  
Kränkte seinen heil'gen Willen.  
Und so muß das Rechte scheinen**

Was auch Mahomet gelungen;

Nur durch den Begriff des Einen  
Hat er alle Welt bezwungen.”

*“Jezusi ndjehej i pastër dhe qetësisht mendonte  
[për] Një dhe të Vetmin Zot;  
Kush atë vetë në zot e shndërroi  
Ka fyter vullnetin e tij të shenjtë.  
Dhe kështu duhet e drejta ta ndriçojë  
Atë që edhe Muhammedi mori;  
Vetëm me konceptin e [Zotit] Një  
Ai gjithë botën ka mbizotëruar.”*

(WA I6, faqe 288)

Pranë Jezusit dhe Muhammedit (Allahu i bekoftë dhe i dhëntë paqe që të dyve) në vargjet e mëpasme përmend Gëte edhe emrat e Abrahomit, Moisiut dhe Davidit si përfaqësues të Njëshmërisë së Zotit.

Është një fakt i njojur se Gëte ndjente shumë përcimim ndaj simbolit të kryqit. Ai ka shkruar:

**“Und nun kommst du, hast ein Zeichen  
Dran gehängt, das unter allen...  
Mir am schlechtesten will gefallen  
Diese ganze moderne Narrheit  
Magst du mir nach Schiras bringen!  
Soll ich wohl, in seiner Starrheit,  
Hölzchen quer auf Hölzchen singen?...”**

*“Dhe tash më vjen ti me një shenjë  
 Varur atje, që mes të tjerash...  
 Më tepër e përcmoj.  
 Gjithë këtë çmenduri moderne  
 Do të ma sjellësh në Schiras!  
 U dashka që unë, në gjithë obsesionin e saj,  
 Të këndoj për dy copa druri të kryqëzuara?..”*

Madje edhe më fuqishëm:

**“Mir willst du zum Gotte machen  
 Solch ein Jammmerbild am Holze!”**

*“Dashke të bësh përmua zot  
 atë figurë të mjerë në [atë copë] dru!”*

Gjithashtu, në “Wilhelm Meisters Wanderjahre” (libri 2, kapitulli 2) Gëte shkroi fare hapur se është “paturpësi e mallkuar... të luash me ato të fshehta, në të cilat qëndron thellësia hyjnore e vuajtjes.” Sipas tij, “mbi këto vuajtje dubet hedhur një vel” për t’i mbuluar.

Së fundi, në poezinë e tij “Siebenschläfer (*Shtatë të fjetur*)” që bën pjesë në poemën e tij “West-Östlicher Divan”, Gëte e përshkruan Jezusin si profet:

**“Ephesus gar manches Jahr Schon,  
 Ehrt die Lehre des Propheten  
 Jezus. (Friede sei dem Guten!)”**

*“Efesi për shumë vjet,  
Nderon mësimin e profetit  
Jezus. [Paqja qoftë mbi të Mirin!”*

(WA I6, 296)

### TË PËRMENDURIT DHE TË LËVDUARIT E ZOTIT

Gëte ishte, gjithashtu, i mrekulluar nga metafora mistike e Saadiut për “fluturën e dashuruar”, e cila u shua pak nga pak, duke humbur jetën e saj në dritën vezulluese. Për këtë mund të shihet, veçanërisht, poezia e “Divan...”-it për fluturën që fluturon nëpër dritë: “*Selige Sehnsucht*” (Mall i zjarrtë). Titujt më të hershëm të kësaj poezie kanë qenë “*Selbstopfer (Vetëflijim)*” dhe “*Vollendung (Pëkryerje)*”.

Në kapitullin e “Divan....”-it për Rumin Gëte përshkruan të drejtuarit me lutje e lëvdime ndaj Allahut dhe bekimin për këtë: “*Schon der sogenannte mahometanische Rosenkranz, wodurch der Name Allah mit neunundneunzig Eigenschaften verherrlicht wird; ist eine solche Lob- und Preis-Litanei. Bejahende, vorneinende Eigenschaften bezeichnen das unbegreifliche Wesen; der Anbeter staunt, ergibt und beruhigt sich*” “*E ashtuquajtura rozare muhamedane, në të cilën emri i Allahut lartësohet me nëntëdhjetenëntë cilësi është një litani e tillë lëvdimi. Cilësi pohuese e*

*mohuese tregojnë të pakonceptueshmen Qenie [Wesen]; lutësi imbetet i mrekulluar, nënshtronhet dhe qetësohet.).”*  
 (WA I7, 59)

## GËTE DHE ISLAMI

Në rininë e tij Gëte kishte dëshirë të studjonte filologji dhe arabistikë (ndërkoq që i ati dëshironte që i biri të merrej me studime juridike); ai gjithmonë i admiroi udhëtarët e parë në Arabi (Michelis, Niebuhr), dhe lexi i mrekulluar gjithçka ata shkruan e botuan për udhëtimet e tyre.

Në vitet 1814-1815, vite këto në të cilat hartoia “Divan...” - in e tij, u ushtrua Gëte me profesorët e orientalistikës Paulus, Sorsbach dhe Kosegarten (Jena) në të shkruarit dhe të lexuarit e arabishtes. Pasi pa dorëshkrime të arabishtes dhe u njoh me Kur'anin, Gëte ndjeu një dëshirë të madhe për të mësuar arabishten. Ai kopjoi vetë tekste të shkurtra lutjesh dhe shkroi: “**In keiner Sprache ist vielleicht Geist, Wort und Schrift so unanfänglich zusammengekörpert**” “(*Ndoshëtë në asnjë gjuhë tjetër shpirti, fjala dhe shkrimi nuk mund të trupëzohen në mënyrë kaq origjinale*).” [Letër për Schlosser-in, 23.1. 1815, WA IV, 25, 165]

Në moshën shtatëdhjetë vjeçare Gëte shkruan (**Noten und Abhandlungen zum West-Östlichen Divan, WA 17, 153**), se synon të festojë “*me respekt atë Natë të shenjtë, në të cilën Profetit iu soll Kurani nga lart*”.

Ai gjithashtu shkroi: “*Askush nuk duhet të habitet me efikasitetin e lartë të Librit. Për këtë ai është cilësuar si jo i krijuar dhe i përjetshëm bashkë me Zotin nga ana e admiruesve të vërtetë të tij*”. Më pas shtonte): “**so wird doch dieses Buch für ewige Zeiten höchst wirksam verbleiben**” “(*kështu, pra, do të mbetet ky libër përjetësisht me efikasitetin më të lartë*).” (WA 17. 35/36)

Edhe në ditët e sotme ne ruajmë si dorëshkrimet e studimeve të tij të para kuranore nga vitet 1711-1772, ashtu edhe ato më të vonshmet. Gëte u lexonte me zë të lartë anëtarëve të familjes së Dukës së Vajmarit dhe miqve të tyre përkthimin në gjermanisht të Kuranit nga J.Hammer (ndoshta edhe përkthimin më prozaik në anglisht të G.Sale). Shileri dhe e shoqja, që kanë qenë dëshmitarë të këtyre leximeve, na njoftojnë për to. (Letra e Shilerit për Kimbelin, 22.2.1815).

Gjithmonë Gëte i ndjente mangësitë e të gjitha përkthimeve në latinisht, anglisht e frëngjisht) dhe të përkthimeve më të reja. Në “Divan...”-in e tij Gëte thotë:

**“Ob der Koran von Ewigkeit sei?  
Danach frag’ ich nicht!...  
Daß er das Buch der Bücher sei**

## Glaub ich aus Mosleminen-Pflicht”

*“(Nëse Kurani është nga përjetësia?  
Për këtë unë nuk pyes!...  
Që ai është Libri i Librave  
Besoj nga detyrë e muslimanit)”*

[West-östlicher Divan, WA I6, 203]

Ai studioi libra dore në arabisht, gramatikë, libra udhëtimi, libra ngajeta e profetit Muhammed (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe) dhe pati shkëmbime të shumta me orientalistë nga e gjithë Gjermania. Gëte e pëlqente përkthimin në gjermanisht të Hafis’ “Divan”-it nga Hammer (Maj 1814) dhe studjonte përkthimet e ndryshme të Kuranit në kohën e tij. E gjithë kjo e shtyu atë që të shkruante **“West-Östlicher Divan”**-in e tij, shumë nga poezitë e të cilit janë qartësisht dhe pa asnje dyshim të frysmezuara nga ajete (vargje) të ndryshëm të Kuranit dhe të lidhura në mënyra të ndryshme me to (shih: Mommsen, faqe 269-274)

Gëte bleu dorëshkrime origjinale në arabisht të Rumit, Xhamit, Hafisit, Saadiut, Attarit, komentime të Kuranit (Tefsir), lutje të ndryshme (Duâ), një fjalor arabisht-turqisht, tekste rreth çështjeve si lirimi i skllevërve, blerja, kamata dhe shkrime arabe nga sulltan Selimi.

Gëte nuk mendonte se kishte pasur të bënte me rastësi, por me atë që Allahu kishte parapërcaktuar për të, kur:

27 Jan 1816

*Landmarks of  
the Islands of Hawaii*

د سر رفایو

Was mit dem Tote geschehet  
Gott nicht auf Geise.

Observe the following  
of which

*Somers*  
Was with grade outfit and  
filled with pride in it's organization  
for our birth day and

# DORËSHKRIMET E GËTES TË VITIT 1816

## **“PRIJËSI I QENIEVE NJERËZORE/MUHAMMEDI”**

- në vjeshtën e 1813 atij iu soll një dorëshkrim i vjetër në arabisht prej një ushtari gjerman që kthehej nga Spanja në atdhe, dorëshkrim ky që përbante suren (kapitullin) e fundit të Kur'anit, të titulluar En-Nas (114). Më vonë Gëte u përpoq që ta kopjonte atë me ndihmën e profesorëve në Jena, të cilët e ndihmuan edhe për të zbërtyer përbajtjen e dorëshkrimit.

- në Janar të vitit 1814 ai mori pjesë në një falje kongregacionale të së premtes (x huma) bashkë me muslimanët e ushrisë ruse të Car Aleksandrit në gjimnazin protestant të Vajmarit. Në letrën për Trebran më 5.1.1814 (WA IV 24,91) ai shkruan:

*“Kur bëj fjalë për profeci, më duhet të vërej se në kohën tonë po ndodhin gjëra për të cilat asnje profet nuk do ta kishin lejuar të fliste. Kush do të lejohej përpara disa vjetësh që të bënte të ditur se në auditorin e gjimnazit tonë protestant do të mbahej shërbesë hyjnore muhamedane dhe se suret (kapituj) e Kur'anit do të murmuriteshin në të, por ja që kjo po ndodh dhe ne morëm pjesë në shërbesën bashkire, pamë Mullain e tyre dhe u uruam mirëseardhjen princërve të tyre në teatër. Mua mu bë një nderim i veçantë duke mu dhuruar një hark dhe shigjeta, të cilat, në kujtim të përjetshëm do t'i var mbi oxhakun tim sapo Zoti t'u ketë siguruar këtyre mysafirëve të dashur një kthim të mbarë”.*

Në një letër që mban datën 17.1. 1814 (WA IV 24,110) drejtuar birit të tij August, ai shkruan: “*Shumë prej*

*zonjave tona fetare kanë kërkuar në bibliotekë përkthimin e Kuranit”.*

Qëndrimi pozitiv i Gëtes ndaj Islamit i kapërcen të gjitha qëndrimet e kohës së tij në Gjermani. Më 24.2.1816 ai bëri publike këtë thënje: “**Der Dichter... lehnt den Verdacht nicht ab, daß er selbst ein Muselmann sei**” “(*Poeti [Gëte] nuk e mohon supozimin se ai është një musliman*).” (WA I 41, 86)

Në njëren nga poezitë e “Divan...”-it të tij Gëte thotë:

“**Närrisch, daß jeder in seinem Falle  
Seine besondere Meinung preist!  
Wenn Islam Gott ergeben heißt,  
In Islam leben und sterben wir alle.”**

“(Cmenduri, secili në rastin e vet  
Mendimin e tij të veçantë lëvdon!  
Nëse Islam do të thotë nënshtrim ndaj Zotit  
Ne jetojmë dhe vdesim të gjithë në Islam.)”

(WA I6,128)

Përveç simpatisë së tij të veçantë për gjuhën e Kuranit, për bukurinë dhe paarritshmérinë e saj, Gëte ndjehej shumë i tërhequr edhe nga domethënia e saj fetare dhe filozofike. Njëshmëria e Zotit, bindja se Zoti shfaq vetveten në natyrë/krijim nepërmjet cilësive të tij të

përkryera, është nga temat qendrore të veprës së Gëtes.

Gjatë studimeve të tij të para intensive të Kuranit në vitet 1771-1772 Gëte kopjoi dhe përmirësoi pjesërisht tekstin e përkthimit të parë të drejtpërdrejtë të Kuranit nga arabishtja në gjermanisht. Gëte vuri në dukje ajete të ndryshëm të Kuranit që i tregojnë njeriut se ai duhet t'i shohë natyrën dhe dukuritë e saj si shenja të ligjshmërisë hyjnore. Shumëlojshmëria dhe panumërsia e këtyre dukurive dëshmojnë për Një dhe të vetmin Zot. Referimi ndaj natyrës ashtu siç e paraqet atë Kurani, lidhja e ngushtë me të mësuarit e mirësisë Hyjnore e njerëzore dhe Njëshmëria e Zotit, të cilat Gëte shkruan se i njoihu në suren e dytë të Kuranit (El-Bekare), u bënë themelë mbi të cilat u ngritën simpatia dhe dashuria e tij për Islamin. Ai tha se ne duhet ta njohim “Madhështinë e Zotit në vogëlsi (**Gottes Größe im Kleinen**)” duke iu referuar për këtë ajitet 25 të sures së dytë Kuranit, në të cilën është dhënë shembulli i mizës.

Veçanërisht i impresionuar ndjehej Gëte edhe nga fakti se Allahu i flet njerëzimit nepërmjet profetëve; kështu Gëte pohon profetin Muhammed (Allahu e bekoftë dhe i dhëntë paqe): më 1819 ai, duke iu referuar sures “**Ibrahim**”, ajeti 4, shkruan:

**“denn es ist wahr, was Gott im Koran sagt: Wir haben keinem Volk einen Propheten geschickt, als in seiner Sprache!”** “(prandaj është e vërtetë ajo që Zoti thotë në Kur'an: Nuk i kemi dërguar asnje populli profet,

*përveçse në gjuhën e tij!)"* [Letër për A.O. Blumentahl, 28.5. 1819, WA IV 31,160]

Duke iu referuar të njëjtit ajet, ai e përsërit atë në një letër për Carlyle: “**Der Koran sagt: Gott hat jedem Volke einen Propheten gegeben in seiner eigenen Sprache**” “*(Kurani thotë: Zot i ka dërguar çdo populli nga një profet në gjuhën e tij)*” (WA IV 42, 270)

Këtë pikëpamje e rishfaq Gëte edhe në një esé të tij në revistën “**German Romance**”, Vëllimi IV, Edinburgh 1827 (WA I 41, 307).

Gëte theksoi hedhjen poshtë të sfidës së mosbesimtarëve ndaj profetit Muhammed (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi tël!), të cilët kërkonin që ai t'u bënte mrekullira:

“**Wunder kann ich nicht thun sagt  
der Prophete,  
Das groBte Wunder ist daß ich bin**”

“(Mrekulli nuk mund të bëj, tha  
Profeti,  
Mrekullia më e madhe është që  
unë jam).”

(Paralipomena III, nga Divani,

WA I, 41, 307)

Në veprën “**Mahomet**” Gëte përfshiu këngën e tij të famshme të lavdisë “**Mahomets Gesang**” (*Kënga e Muhammedit*). Figura e profetit është simbolikisht e vendosur në metaforën e rrymës, e cila pasi ka nisur nga një përrua i vogël, rritet dalëngadalë duke u shndërruar në një forcë të pafundme shpirtërore për të përfunduar plot lavdi në oqeanin, si simbol të së hyjshmes. Ai e përshkruan gjeniun e madh të fesë duke tërhequr pas vetes të tjerë njerëz, ashtu sikurse rryma, me forcën dhe madhështinë e saj, tërheq të tjerë përrenj e lumenj në udhën drejt detit.

Në një dorëshkrim të Paralipomena III, 31 Gëte shkruan më 27.01.1816: “**Oberhaupt der Geschöpfe / Muhammed**” “(*Kreu i qënieve të krijuara / Muhammedi*)”(WA I6, 482)

Një tjetër element domethënës i Islamit është vendosja e theksit tek sjellja e mirë e muslimanit. Veçanërisht në këtë kuadër pëlgente Gëte dhëni e sadakasë si ndihmë për të varfërit. Në disa poezi të tij, si p.sh. në “**Buch der Sprüche**”, përshkruan ai “*die Wonne des Gebens (kënaqësinë e të dhënit)*” dhe thotë: “*Schau es recht und du wirst immer geben (Gjykoje drejtësisht dhe gjithmonë do të japësh)*”(WA I6, 70).

Ajo që e tërhoqte në këtë rast Gëten ishte fakti se ky akt nuk përbënte ndonjë investim për çastin apo për pak më vonë, por mbushte gjithë jetën plot bekime.

Gëte ishte gjithashtu i mirënjohnur për refuzimin e qartë nga ana e tij të konceptit të rastësisë:

*“Ajo që njerëzit, me përpjekjet e tyre, nuk e realizojnë apo nuk munden ta realizojnë dhe ajo që u ecën mbarë aty ku duhet të shkëlqejë më së miri madhështia e tyre, rastësia, siç e quajnë më vonë, pikërisht ajo është Zoti, i Cili ndërhyt aty drejtpërdrejt me Gjithfuqishmërinë e Tij dhe Lëvdon Vetveten edhe nepërmjet gjësë më pak të rëndësishme”.* (Bisedë me Reimer-in, nëntor 1807)

Besimi i tij i palëkundshëm në parapërcaktimin e Zotit (shihni si shembull bisedën me kancelarin Müller më 12.8.1927, WA I 42, 212, WA I 32, 57) dhe vargu i një poezie të “Divan...”-it të tij: **“Hätt Allah mich bestimmt zum Wurm,/ So hätt’ Er mich als Wurm geschaffen”** **“(Nëse Allahu do të kishte vendosur që unë të isha krimb,/ Ai do të më kishte krijuar mua si krimb).”** (WA I 6.113), si dhe fjalët e tij: **“Parabolat (metaforat e “Divan..”-it) mësojnë Islamin e vërtetë, bindjen se askush nuk mund t’i ikë fatit të paracaktuar për të.”** (WA I 7, 151), të gjitha këto rezultuan në qëndrimin e tij personal të nënshtimit ndaj vullnetit të Zotit; d.m.th. Gëte e shihte atë si një urdhër që duhet pranuar me mirënjoheje dhe jo duke u rrebeluar.

Në veprën e tij letrare gjejnë pasqyrim shembuj të fuqishëm për këtë, nga të cilët mund të përmendim **“Egmont”**, **“Dichthung und Wahrheit”**, **“Urworte** **“Meisters Wanderjahre”** etj....


Një shembull thellësisht prekës ngajeta e tij është reagimi ndaj një aksidenti që i ndodhi karrocës së tij kur ai ishte nisur në udhëtimin e tij të tretë për tek Marianne von Willemar (korrik 1816), me të cilën mendonte të martohej pas vdekjes së Kristjanës, gjë për të cilën ndjehej shumë i hidhëruar. Pas këtij aksidenti ai e kuptoi se nuk do ta shihte më kurrë Marianne von Wilmer-in. Lidhur me këtë Gëte shkruan:

**“Und so müssen wir denn wieder im Islam verharren”** “(*Dhe, kështu, na duhet të qëndrojmë brenda Islamit [d.m.th.: në nënshtrim të plotë ndaj vullnetit të Zotit]*)...”(WA IV 27, 123)

Të njëtën gjë thotë ai edhe në një letër drejtuar Zelter-it, letër kjo, që mban datën 20.9.1820: “**Weiter kann ich nichts sagen, als daß ich hier mich im Islam zu halten suche**” “(*Më tepërnuk kam ç’them, përveç asaj se edhe këtu unë përpinqem të qëndrojnë Islam*).”(WA IV 33, 123)

Kur më 1831 u shfaq një epidemi kolere nga e cila vdiqën shumë njerëz, nepërmjet një letre Gëte e ngushëllon kështu një mikën e tij, Louise Adele Schopenhauer: “**Hier kann niemand dem anderen rathen; beschließe was zu thun ist jeder bei sich. Im Islam leben wir alle, unter welcher Form wir uns auch Muth machen**” “(*Këtu askush nuk mund të këshillojë njeri; secili duhet të vendosë vetë se çfarë duhet të bëjë. Ne të gjithë jetojmë*

*në Islam, pavarësisht nga forma që zgjedhim për të inkurajuar vetveten).”*(19.9.1831, WA IV, 49, 87)



Më 22.12.1820 Gëte i shkroi një letër falenderimi mikut të tij Willemer, i cili i kishte dhuruar një libër me aforizma. Në këtë letër, mes të tjera, Gëte shkruan: “**Es stimmt... zu jeder religiosvernünftigen Ansicht und ist ein Islam, zu dem wir uns früher oder später alle bekennen müssen**” “(*Mbështetet... në çdo pikëpamje të arsyeshme fetare dhe është një Islam, të cilin ne, herët a vonë, të gjithë duhet ta pranojmë*).”(WA IV 34,50)

Si pjesmarrës në Luftën e 1792 kundër Francës, shkruan Gëte më 7-8 tetor 1792 se besimi në parapërcaktimin e gjithçkaje nga Zoti gjen shprehjen e tij më të pastër në Islam:

“**...Die Mahomedanische Religion gibt hervor den besten Beweis**” “(*Feja Muhamedane jep shembullin*

*më të mirë per këtë” (WA I 33,123)*

Eckerman na njofton për një bisedë të tij me Gëten më 11.4.1827 rrëth metodës së edukimit të muslimanëve. Sipas Gëtes, kjo metodë edukimi konsistonte në të vërejturit e vazhdueshëm nga ana e muslimanëve të kundërshtive në egzistencë; si rezultat vjen takimi me dyshimin, që, pas analizës së suksesshme të realitetit të gjërave, përfundonte në zgjidhjen e sigurtë. Gëte e myll këtë diskutim kështu:

*“Ju e shihni se këtij sistemi nuk i mungon asgjë dhe se ne, me të gjithë sistemet tona, nuk jemi aspak më të përparuar, madje askush nuk mund të shkojë më përpara ... Ky sistem filozofik i muslimanëve është një masë e shkëlqyer, të cilën njeriu mund ta aplikojë tek vetvetja dhe tek të tjerët për të mësuar se në ç'nivel të virtytit shpirtërор jemi”.*


Për gjëra që nuk arrijnë deri tek aftësia e njeriut për të kuptuar dhe që mund të shërbijnë si bazë për spekulime të ndryshme Gëte porosit në “**Maximen und Reflexionen**” që të mos merremi me to: “*Më i madhi fat i njerëzve që mendojnë është eksplorimi i të eksplorueshmes dhe admirimi i qetë i të paeksplorueshmes*”. Kjo është e lidhur me kujdesin e muslimanëve për të mos pyetur rrëth gjërave që nuk mund të dihen nga njerëzit.

Për Njëshmërinë e Zotit Gëte tha: “**Der Glaube an den**

einigen Gott wirkt immer geisterhebend, in dem er den Menschen auf die Einheit seines eigenen Inner zurückweist” “(*Besimi në një Zot të vetëm është gjithmonë i efektshëm për ngritje shpirtërore, sepse ai tregon për njeriun njëshmërinë brenda vërvetes*).” (Noten und Abhandlungen zum West- östlichen Diwan, WA I 7, 42)

Gëte bën fjalë për ndryshimin mes një profeti dhe një poeti dhe pohon të qenit profet të Muhammedit (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe!):

“Er sei Prophet und nicht Poet und daher auch Sein Koran als göttliches Gesetz und nicht etwa als menschliches Buch, zum Unterricht oder zum Vergnügen, anzusehen.” “(*Ai është profet dhe jo poet dhe kështu edhe Kurani i tij duhet parë si Ligj Hyjnor dhe jo si ndonjë libër njerëzor, bërë përedukim apo për argëtim*).” (Noten und Abhandlungen zum Diwan, WA I, 7, 32)



**SHEJH ABDALKADIR AL-MURABIT**

## PËRFUNDIM

Pas analizimit të provave materiale të parashtruara më sipër dhe njohjes së provave konfirmuese në shkrimet e miqve të tij të ngushtë Thomas Carlyle dhe Friedrich Schiller, është e mundur të vijmë në një përfundim të qartë, pa lënë vend për dyshim apo dykuptueshmëri.

Gjithçka që përbajnjë shkrimet e tij shkencore, veçanërisht “**Zur Morphologie**”, mbetet një propagandim i vazhdueshëm i pikëpamjes se gjithësia është krijim i një Qenieje Hyjnore dhe se Qenia e Krijuesit nuk përzihet me qeniet e krijesave.

Ndërkohë që jetonte jetën e tij në një vend jomusliman, ai pranoi dhe deklaroi pajtim me plot zemër të dy dëshmive (*Shehadet*) dhe pohoi se nuk mund të ketë tjetër Zot veç Allahut, Një dhe i Vetëm, e se Muhammedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të!) është i dërguari dhe, njëkohësisht, vula e të gjithë të dërguarve të Tij.

Megjithëse i pamësuar për lutjen rituale (namazin ose faljen), dhënien e zekatit, agjërimin dhe pelegrinazhin e shenjtë (haxhin), ai shfrytëzoi plot krenari e emocion të thellë rastin e rrallë për të marrë pjesë në faljen e ndonjë të premteje. Nga e gjithë kjo del qartë se ai e shihte Islamin

si Fenë e tij.

Nga hadithet (traditat profetike) e shumtë dhe të mirënjohur të transmetuar nga Buhari dhe Muslimi si dhe të haditheve të tjerë autentikë të koleksionit të Sunnetit është e njojur se pranimi i Allahut dhe i të dërguarit të Tij është çelësi i Parajsës (Xhennetit).

Kështu mund të pranohet hapur se poeti më i madh i Europës, lavdia e gjuhës gjermane dhe e jetës intelektuale është gjithashtu i pari i muslimanëve në Europën moderne, duke rizgjuar në zemrat e njerëzve dëshirën dhe njojen e Zotit dhe të të dërguarit të Tij.

**JOHANN WOLFGANG VON GOETHE (1749 – 1832)**  
 është poeti dhe mendimtari më i njojur i Klasikës Gjermane. Një nga veprat më madhështore të tij është “**West-Östlicher Divan**”, që doli për herë të parë më 1918. Kjo vepër shënon pikën e tij më të lartë të angazhimit të tij me Islamin.

**SHEJH ‘ABDULKADIR AL-MURABIT**

**AUTORIZUAR NGA KRYETARI I BASHKËSISË ISLAME**

**TË VAJMARIT HAJJI. ABU-BAKER. RIEGER.**

**VAJMAR, 19 DHJETOR 1995**